



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumëmemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Nr . 517 i vendimit Data 17.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Partia Socialiste e Moderuar, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë Shkodër, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezultoi se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar asnjë të dhënë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, sipas së cilës rezultoi:

Numri rendor 07, z. Gjin Nika është i dënuar:

Me vendim nr. 174 dt.05.07.2001 Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "vjedhjes", e në bazë të nenit 134, 25 K.Penal dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim.

Me vendim nr.145, dt.06.06.2002 Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "vjedhjes me dhunë", parashikuar nga neni 139, 25 K.Penal e dënohet 5 (pesë) vjet burgim.

Me vendimin nr.163, dt.03.10.2002 Gjykata Apelit Shkodër vendosi lënien në fuqi vendimit.

Me vendim nr.173-1115, dt.26.03.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "organizimit të llotarive të palejuara", e në bazë të nenit 197 K.Penal dhe nenit 406/1 K.Pr.Penal dënohet me 34.000 lekë gjobë.

Me vendim nr.803 dt.08.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është deklaruar fajtor për veprën penale "mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit", parashikuar nga neni 278/3 I K.Penal e dënon me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 59 K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të tij për një periudhë kohe prej 2 vjetësh.



Nr . 517 i vendimit Data 17.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

KQZ, në zbatim të ligjit 138/2015 duhet të shqyrtojë nëse janë evidentuar nga procesi i verifikimit të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga neni 2 i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Vepra penale "mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit", parashikuar nga neni 278/3 i K.Penal e dhe koha e dënimit dënimit me 1 vit burgim përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar të nenit 2, pika 1, germa "ç" e ligjit 138/2015.

Sipas parashikimeve të pikës 13 të Vendimit të Kuvendit 17.2016, KQZ pas i konstatoi se të dhënat përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2 i ligjit 138/2015, KQZ verifikoi nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në neni 4 të ligjit nr.138/2015.

Referuar nenit 4, pika 4 për personat që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar datës së vendimit nr.803 dt.08.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, masës së dënimit me 1 (një) vit burgim, neni 69 të Kodit Penal, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, z. Gjini Nika përfshihet brenda periudhës së ndalimit për kandidimin në funksionin e këshilltarit të këshillit bashkiak

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturave, referuar nenit 10 pika 1, germa "a" të ligjit 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e z. Gjini Nika, dhe t'i kërkoj subjektit zgjedhor Partisë Socialiste të Moderuar të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidaturave.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Nr . 517 i vendimit Data 17.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

VENDOSI:

1. Të refuzojë kandidaturën e z. Gjin Nika për këshillin e bashkisë Shkodër, PSM.
2. Njoftimin e Partisë Socialiste të Moderuar të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidatëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 517 i vendimit Data 17.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.